

## Vendimi 2021-KG01

Data: 19.03.2021

Meçi final i vajzave “Kalaja Juniors 2021 – U16”

### VENDIM

- Komisionerja e Garave znj. Mërgime Mula bazuar në rrethanat, faktet dhe në harmoni me rregullat e sjelljes në fuqi të ITF ka vlerësuar situatën në lidhje me meçin final të vajzave të turneut “Kalaja Juniors 2021-U14”, i cili u ndërpre nga kërkesa e parashtruar e lojtares Forta Morina si pasojë e ndriçimit të dobët dhe paaftësisë për të vazhduar meçin në ato kushte.
- Komisionerja e Garave merr këtë **vendim:**

Finalja e vajzave mes Aja Broqit dhe Forta Morina ka përfunduar ditën e diele kur është zhvilluar meçi, në momentin e ndërprerjes së garës nga Forta Morina e cilësuar si dorëzim i lojës, me çast fitorja i kalon tenistes Aja Broqit.

#### Arsyetim:

1. Meçi mes Forta Morina dhe Aja Broqi ka filluar të luhet rreth orës 16:00 nën ndriçim natyral ndërkaq pas rezultatit 6:1 4:2 0:40, ndërprehet nga Forta Morina me arsyetimin e ndriçimit të dobët;
2. Gjatë meçit Forta Morina dhe Aja Broqi ka pasur dritë natyrale të mjaftueshme për lojë, edhe pse një pjese e dritave artificiale nuk ka funksionuar.
3. Kategoria e djemëve u zhvillua menjëherë pas incidentit me vullnetin e lirë të dy lojtarëve i cili meç ka përfunduar me sukses dhe pa probleme madhore.
4. Vendimi është bazuar edhe nga raporti/arsyetimi i supervajzerit te turneut.

Seksion i shkëputur nga Kodi i Sjellës të ITF:

#### **Dështimi për të përfunduar ndeshjen apo turneun;**

*“Një lojtar duhet të përfundojë një ndeshje në zhvillim, dhe të përfundojë turneun, përveç nëse ai / ajo është në mënyrë të arsyeshme e paaftë për ta bërë këtë. Shkelja e këtij Seksioni do t'i nënshtrojë një lojtari me një gjobë deri në \$ 750.*

*Në rrethana që janë flagrante dhe veçanërisht të dëmshme për suksesin e turneut, ose janë veçmas e egër, një shkelje e vetme e këtij neni do të përbëjë gjithashtu një shkelje madhore të "Sjellje e Përkeqësuar" dhe do t'u nënshtrohet ndëshkimeve shtesë më poshtë.*

*Nëse një skuadër dyshe nuk arrin të përfundojë një ndeshje në zhvillim ose turne, mbikëqyrësi i ITF do të kenë diskrecion nëse njëri ose të dy anëtarët e ekipit do të sanksionohen sipas kësaj seksioni (Code of Conduct, ITF-).”*